

Relacion mbi krijimin e qendrës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Turizëm në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në kuadër të projektit BLUEWBC.

Zhvillimi i Paketës së Punës 3: Krijimi i qendrave të I&E (Inovacionit dhe Sipërmarrjes) në IAL (Institucionet e Arsimit të Lartë) malazeze dhe shqiptare

- 3.1 Blerja e pajisjeve të reja dhe azhurnimi i pajisjeve ekzistuese
- 3.2 Instalimi dhe testimi i pajisjeve
- 3.3 Krijimi i mjediseve për qendrat e I&E në IAL-të e vendeve patnere

1. Hyrje

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë është një institucion partner në projektin Erasmus +, të titulluar "Zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomive BLU përmes arsimit të lartë dhe inovacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor (BLUEWBC)". Ky projekt u pranua për financim nga Executive Agency for Education, Audiovisual Policy and Culture of the European Union (Agjencia Zbatuese për Arsimin, Politikën Audiovizive dhe Kulturën e Bashkimit Evropian (EACEA)) nën Aksin 2 - Bashkëpunimi për Inovacionin dhe Shkëmbimin e Praktikave të Mira - Ndërtimi i Kapaciteteve në Arsimin e Lartë. Projekti koordinohet nga Universiteti i Shkencës dhe Teknologjisë i Norvegjisë (NTNU), Shkolla e Mesme Alesund (Norvegji). Projekti filloi në 15 Janar 2020 dhe do të zgjasë për tre vjet.

Gjatë periudhës tre-vjeçare të zbatimit të projektit BLUEWBC, partnerët e BE-së dhe jo-BE që do të angazhohen, janë: Fakulteti i Studimeve Detare të Universitetit të Malit të Zi (Mali i Zi), Universiteti i Vlorës "Ismail Qemali" (Shqipëri), Fakulteti i Ekonomisë UT (Shqipëri), Universiteti i Splitit (Kroaci), Universiteti Teknik Vilnius Gediminas (Lituani), Qendra e Trajnimit Detar NTNU - Ocean Training AS nga Alesund (Norvegji), Dhoma e Tregtisë e Malit të Zi (Mali i Zi), Administrata Detare Shqiptare Durrës (Shqipëri) dhe Qendra e Inovacionit dhe Sipërmarrjes Tehnopolis Niksic (Mali i Zi).

Projekti BLUEWBC është krijuar si një iniciativë dhe nevojë e IAL-ve të Ballkanit Perëndimor (Mali i Zi dhe Shqipëria) për të afruar kurrikulat e tyre me nevojat e tregut në një sektor mjaft strategjik për këto vende, siç është ekonomia blu, si dhe për t'u integruar në një masë më të madhe mes tyre në rajon, duke ndjekur përvojat e vendeve të zhvilluara. Më konkretisht, ky projekt synon të zhvillojë kompetencat e IAL-ve në fushat e mëposhtme:

- ekonominë blu, inovacionin dhe sipërmarrjen,
- zhvillimin e kapaciteteve teknologjike dhe inovative në fushën e ekonomisë blu,

- mbështetjen e procesit të bashkëpunimit rajonal në sektorin publik, privat dhe kërkimin shkencor,
- stimulimin e zhvillimit të strategjive të arsimit në ekonominë blu,
- mbështetjen e zhvillimit të iniciativave dhe platformave për bashkëpunim në nivelet më të larta në arsim, turizëm, industrinë detare, mjedis, etj.

Për të përmirësuar Ekonominë Blu bazuar në inovacionin dhe sipërmarrjen në Mal të Zi dhe Shqipëri, është e nevojshme të punohet në lidhjen dhe shkëmbimin e përvojave pozitive dhe praktikave më të mira me BE dhe vendet e rajonit. Në përputhje me rrethanat, institucionet e arsimit të lartë në fushën e ekonomisë Blu në këto vende të Ballkanit Perëndimor, kanë njohur dhe vlerësuar rëndësinë e lidhjes me institucionet e arsimit të lartë të njohura dhe me përvojë shumë të mirë, si dhe përfaqësues të industrisë nga BE dhe vendet e rajonit. Për të arritur përmirësimin e këtyre kompetencave, në vendin tonë ky projekt implementohet në dy nivele: në fushën e turizmit (UT) dhe në inxhinierinë detare (UV), si pjesë përbërëse të ekonomisë blu. Fokusi në fushën e turizmit korrespondon me përparësitë rajonale, kombëtare dhe ndërsektoriale të vendit tonë.

Një nga qëllimet praktike të këtij projekti është krijimi i Qendrës për Inovacion dhe Sipërmarrje në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Si rrjedhim, në FEUT kjo qendër do të ketë në fokus zhvillimin e turizmit, duke qenë dega e lidhur drejtpërdrejt me ekonominë blu.

2. Qëllimet dhe objektivat e Qendrës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Turizëm

Qëllimet kryesore të Qendrës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Turizëm, janë:

- T'u mundësojë studentëve, kryesisht të profilit të turizmit, të zbatojnë në praktikë njohuritë teorike të marra gjatë studimeve, kryesisht për të aplikuar konceptet në lidhje me Inovacionin dhe Sipërmarrjen në fushën e Turizmit.
- Të sigurojë mundësi dhe infrastrukturë për kërkime multidisiplinare të aplikuara.
- Të promovojë kërkim, ide dhe zgjidhje në fushën e inovacionit dhe sipërmarrjen në Fakultetin e Ekonomisë, Universitetin e Tiranës.
- Të përmirësojë infrastrukturën të rrisë kapacitetet e Fakultetit të Ekonomisë, Universitetit të Tiranës për projekte dhe iniciativa të ardhshme kombëtare / ndërkombëtare (trajnime, inkubatorë biznesi, mësim gjatë gjithë jetës - LLL, etj)
- Të mbështesë dhe promovojë zhvillimin e turizmit në Shqipëri përmes transferimit të njohurive dhe teknologjisë në këtë fushë.
- Të përmirësojë lidhjen dhe ndërveprimin midis akademisë dhe industrisë, me fokus në ekonominë blu.
- Të rrisë bashkëpunimin me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, kompani publike dhe private.
- Të promovojë Universitetin e Tiranës në nivelin lokal dhe ndërkombëtar (kurset, programet e studimit, kërkimin shkencor, arritjet, etj).

- Të promovojë burimevet kërkimore dhe inovative në Universitetin e Tiranës.
- Të nxisë dhe të rrisë bashkëpunim intensiv ndërkombëtar, pjesëmarrje dhe menaxhim të projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare;

3. Aktivitetet e Qendrës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Turizëm

Përmes Qendrës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Turizëm duhet dhe do të kryhen aktivitetet e mëposhtme:

- Aktivizimi i studentëve në projekte inovatore që nxisin sipërmarrjen, kryesisht në turizëm;
- Zhvillimi i konkurseve, trajnimeve, orëve të hapura dhe aktiviteteve të tjera që synojnë të nxisin zhvillimin e njohurive dhe aftësive të studentëve në inovacion dhe sipërmarrje;
- Mbledhja e të dhënave në lidhje me potencialet për kërkimin, sipërmarrjen dhe inovacionin në Fakultetin e Ekonomisë, Universitetin e Tiranës;
- Kryerja e kërkimit të thelluar dhe të aplikuar multidisiplinar;
- Zhvillimi i partneriteteve me kompani dhe lidhja e studiuve/kërkuesve dhe studentëve me partnerët e biznesit;
- Sigurimi i mbështetjes dhe forcimi i lidhjeve me inkubatorët e biznesit, qendrat e inovacionit dhe sipërmarrjes, si dhe mjediseve (parqeve) të shkencës dhe teknologjisë.
- Pjesëmarrje e përbashkët në treg me njësitë e tjera që merren me transferimin e njohurive dhe teknologjisë në fushën e ekonomisë Blu dhe veçanërisht turizmit;
- Sigurimi i qasjes në burime, pajisje, trajnime, rezultate të hulumtimeve, patentave dhe licencave të ofruara për mjedisin e biznesit;
- Organizimi i konferencave shkencore, seminareve;
- Kryerja e kërkimeve multidisiplinare, etj.

4. Pajisjet e Qendrës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Turizëm

Në kuadër të projektit BLUEWBC do të prokurohen pajisjet e mëposhtme për pajisjen e kësaj Qendre:

Nr.	Pajisja	Njësia	Sasia
Pajisje për kërkim shkencor			
1	Syze gjurmuese për kërkim (Eye tracking glasses with recording unit and controller app)	Set	1
2	Software analizues për syzet (Analyzer Edition software) + trajnim	Licensa	1 pro +10 student
3	Software për databazë statistikore dhe modelim të ekuzcioneve strukturore (Statistic database software with structural equation modeling software)	Licensa	1

Pajisje IT			
4	Notebook	Copë	4
5	Kompjuter all in one (All in one PC)PC	Copë	10
6	Tabelë interaktive (Interactive Board)	Copë	2
7	Printer 3D	Copë	2

5. Burimet njerëzore

Personeli mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës i Departamentit të Marketing-Turizëm, FEUT do të angazhohet brenda Qendrës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Turizëm sipas qëllimeve dhe aktiviteteve të përmendura më parë të Qendrës.

Përveç kësaj, brenda Qendrës do të angazhohen gjithashtu anëtarë të stafit të departamenteve të tjera në FEUT, sipas nevojës.

6. Qëndrueshmëria financiare

Në fazën e parë të zhvillimit të Qendrës së Inovacionit dhe Sipërmarrjes në Turizëm do të sigurohen pajisjet e mësipërme nëpërmjet financimit të projektit BLUWBC. Mobilimi i Qendrës me pajisjet e nevojshme të zyrës, si dhe mirëmbajtja e saj janë përgjegjësi e Fakultetit të Ekonomisë. Qendra do të shërbejë për nevojat direkte të projektit që nga momenti i krijimit deri në përfundim të kohëzgjatjes së tij (Janar 2023). Megjithatë, krijimi i kësaj Qendre është vetëm hapi i parë i nxitjes së ideve sipërmarrëse dhe inovatore në fushën e turizmit. Ajo do të shërbejë edhe përtej kohëzgjatjes së projektit për zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve në fushën e mësimdhënies, kërkimit, teknologjisë, inovacionit dhe sipërmarrjes në turizëm. Ajo do të jetë një bazë kërkimore dhe aplikative për të gjithë studiuesit, studentët apo profesionistët e fushës në të ardhmen. FEUT do të garantojë qëndrueshmërinë e Qendrës dhe përdorimin e saj edhe përtej kohëzgjatjes së projektit.

Koordinatorë Projektit

Prof. Dr. Klodiana GORICA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I EKONOMISË

Tiranë, më 17.06.2021

Lënda: Mbi kërkesat e bëra nga znj. Klodiana Gorica
me shkresën e datës 11.06.2021

Drejtuar: z. Mirdaim AXHAMI
Përgjegjës i departamentit Marketing Turizmit

Për dijëni: znj. Klodiana GORICA
Koordinatore e projektit

Bazuar në kërkesën e dërguar nga koordinatorja e projektit BLUEWBC znj. Klodiana Gorica ju informojmë sa vijon:

1. Vendendodhja e qendrës është përcaktuar në bashkëpunim me departamentin tuaj dhe ky është një problem i zgjidhur.
2. Lidhur me kërkesën për mbështetjen me infrastrukturë fizike për funksionimin e qendrës duhet të komunikoni me administratorin e fakultetit z. Ermal Haxhijaj.
3. Menaxhim i qendrës do të bëhet nga ana e departamentit tuaj si pjesë integrale e tij.
4. Lidhur me pagesat e përfuara nga personeli që ka punuar në këtë projekt përveç informacionit të sjell, duhet të na paraqisni një tabelë përmbledhëse të pagesës së përfuar për secilin anëtar të projektit si dhe përshkrimin e detajuar të punës së bërë mbi bazën e së cilës është kryer pagesa përkatëse e përfuar.

DEKANI

Dhori KULE

Me porosi dhe në mungesë
ZV/DEKANI
Fatmir MEMAJ



Adresa: Rruga "Arben Broci" Fakulteti i Ekonomisë, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2345789, www.feut.edu.al